

## Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare "SKYREAL" SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, unë ortaku z.Marjus Aliu, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "SKYREAL" SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Sot me datë 06/04/2021, formohet shoqëria tregtare private e quajtur "SKYREAL" SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjisllacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjisllacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Kavaje, Zona Kadastrale 8551, Numer pasurie 14/413-ND, Volumi 32, Faqe 151

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblese dhe ortakeve të saj.

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të vecante Franchising, aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme, shitje dhe blerje, agjensi imobiliare. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafert me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të leshojë garanci, letra demshperblimi dhe çdo garanci tjetër reale. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomik

Kohe zgjatja e Shoqërisë

Neni 4


Kohe zgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqindmijë) Lekë.

I. Ortaku themelues Z. Marjus Aliu: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë lekë) që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



## Drejtimi i Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z.Marjus Aliu i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor

i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

### Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakëve.

### Neni 8

Ortakët kanë të drejtë të emerojnë dhe administrojnë të tjerë të vlerave materiale.

Kanë të drejtë të caktojnë financiere, likuidator për problemet e shoqerise si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

### Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

### Neni 10

Shoqeria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

### Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

### Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqerise "SKYREAL" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortakë themelues:

Marjus Aliu

